ETIKA
Audit • Accounting • Tax

Rr. Haxhi Zeka p.n.
Prishtin 10000 Kosovo
Tel: +377 44 147 170
etika-ks@live.com

# RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

**Për bordin e OJQ "Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë "-** ***Prishtinë***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura **OJQ " Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë "** - Prishtinë ( Organizata ), që përfshijnë Pasqyren e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014, Pasqyrën gjithëpërfshirëse e të ardhurave, Pasqyren e rrjedhjen e parasë dhe pasqyrën e ndrrimeve në ekuitet, për vitin që ka përfunduar dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

## Përgjegjesia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhë prezantimin e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të cilat janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të gabimeve dhe mashtrimeve, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

## Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinon mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi bërë auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë përputhshmëri me kërkesat etike si dhe planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të arritur siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimve materiale të pasqyrave financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shrehjes së opinionit në efikasitetitin e kontrollve të brendshme të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatjes së politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare

Ne besojmë se përvec cështjeve të cekur më poshtë, dëshmitë e auditimit që neve i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura të ofrojnë bazë për opinionin tonë.

ETIKA
Audit • Accounting • Tax

Rr. Haxhi Zeka p.n.
Prishtin 10000 Kosovo
Tel: +377 44 147 170
etika-ks@live.com

**Opinion i pa kualifikuar**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura japin një pamje të vërtete dhe të drejtë, në aspektin material pozitën financiare të **OJQ " Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë "** ***- Prishtinë*** me 31 Dhjetor 2014, performancën e saj dhe rrjedhës së parasë për periudhën që ka përfunduar me atë datë në përputhshmëri me ***me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar – SNRF .***

.

ETIKA

Prishtina, Kosovë

Korrik 2015

KOMPANI AUDITIMI -ETIKA- Prishtinë AUDIT COMPANY